INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

TAKSA 100%

VAZHDIM APO PEZULLIM?

SHKURT, 2019

TAKSA 100%

VAZHDIM APO PEZULLIM?

Përgatitën: Jeta Krasniqi, Eugen Cakolli dhe Violeta Haxholli

Kontribuuan: Stafi i KDI-së dhe ekspertë të fushës në fokus grupin e organizuar nga KDI

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi,
Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Vërejtje: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë" dhe përkrahet nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 6

2. HISTORIKU I TAKSËS NDAJ PRODUKTEVE TË SERBISË DHE BOSNJE E HERCEGOVINËS.....7

3. EFEKTET E PËRGJITHSHME TË TAKSËS NDAJ SERBISË DHE BOSNJE E HERCEGOVINËS.....9

4. OPSIONET PËR TAKSËN 11

4.1. Skenarët potencial.....11

SKENARI I: TAKSA PREJ 100% NUK PEZULLOHET 12

SKENARI II: TAKSA PREJ 100% PEZULLOHET 16

1. HYRJE

Dialogu Kosovë-Serbi i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian hyri në një fazë të re në fund të vitit 2017. Ky proces i iniciuar më 2011 si një proces teknik, pas Rezolutës së OKB-së e cila mirëpriste rolin e Bashkimit Evropian si ndërmjetësues të këtij procesi u deklarua se synonte përmirësimin e jetës së qytetarëve të të dyja vendeve dhe që do t'i kontribuonin paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal[1]. I transformuar më 2012 në proces të normalizimit të raporteve apo dialog politik, pas 6 vitesh pësoi transformimin e tretë. Në fazën e re aktuale, të proklamuar si faza përmbyllëse e dialogut, synohet arritja e një marrëveshjeje ligjërisht të obligueshme në mes palëve, e cila deklarohet se duhet të jetë e balancuar[2], e pranueshme dhe e zbatueshme nga të dyja palët[3].

Natyra e dialogut Kosovë-Serbi, i cili që në fillim nuk kishte përcaktuar qartazi parimet prijëse, epilogun e pritshëm të bisedimeve, afatin kohor, garancat e nevojshme si dhe vet qasja e ambiguitetit konstruktiv e përdorur nga ndërmjetësuesi BE, ka bërë që marrëveshjet e arritura në kuadër të tij të mos zbatohen në masë të madhe. Për më tepër, raportet në mes palëve nuk kanë arritur normalizimin e pritshëm, duke u limituar shpesh herë vetëm në shprehjen e gatishmërisë së palëve për dialog dhe në shënimin e momenteve të quajtura dhe nga vet ndërmjetësuesi si 'historike'[4].

Në tashmë 8 vite bisedime Kosovë-Serbi, raportet në mes palëve jo rrallë herë janë tensionuar. Kjo marrëdhënie shënoi kulminacionin me dështimin e Kosovës për tu anëtarësuar në Interpol si pasojë e fushatës agresive të Serbisë kundër shtetit të Kosovës, kur për herë të parë shteti i Kosovës ndërmori veprime me vendosjen e masave tarifore dhe jo tarifore ndaj shtetit të Serbisë si kundërpërgjigje ndaj qasjes së saj destruktive[5].

Këto masa të Qeverisë së Kosovës anashkaluan tryezën e Brukselit si vendin për diskutimin e çështjeve të hapura në mes palëve. Vlen të theksohet se prej vitesh argumentonte se në kuadër të procesit të dialogut nuk ishte dakorduar me Kosovën për pranimin e shtetësisë së saj duke justifikuar sjelljen e saj kundër shtetit të Kosovës. Ndërsa nga vet ana e BE-së kishte mungesë të një reagimi të qartë dhe të pritshëm ndaj qasjes destruktive të Serbisë e cila ndikoi direkt në përkeqësimin e raporteve në mes dy shteteve.

Vendosja e këtyre masave nga ana e Kosovës ka prodhuar një seri efektesh në disa fusha, së pari në vet procesin e dialogut Kosovë-Serbi, pastaj në marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtar, në zhvillimet e brendshme politike në vend, në ekonomi dhe në vet perceptimin e qytetarëve. Instituti Demokratik i Kosovës ka analizuar efektet pozitive dhe negative në këto fusha të ndikimit në dy skenarë: mbajtja e taksës 100% dhe pezullimi i saj. Kjo analizë është zhvilluar gjithashtu në konsultim me një grup të ekspertëve të fushave përkatëse të cilat ofruan kontributin e tyre.

1 Për më shumë, shih: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/UNGA_Resolution_on_Brussels_Dialogue_on_9_September_2010.pdf
2 Për më shumë, shih: https://zeri.info/aktuale/230501/trump-i-shkruan-leter-thacit-per-marreveshjen-me-serbine/?fbclid=IwAR1QIfs8t7_EQmS-sQ5FvWTCVc1pvP3Ko2p_zdChsQFasUiio1IxgnyeglrI4
3 Për më shumë informacione lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi, shih: http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2018/03/18-Sfidat-FINAL-ALB-06.pdf
4 Këshilli Evropian, "Deklaratë nga Presidenti i Këshillit Evropian Herman Van Rompuy, me rastin e marrëveshjes në kuadër të dialogut të lehtësuar mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës", 19 prill, 2013. I qasshëm në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/136877.pdf
5 Masat tarifore dhe jo-tarifore të Qeverisë së Kosovës janë vendosur edhe ndaj Bosnje e Hercegovinës.

2. Historiku i taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës

Qeveria e Kosovës me anë të një sërë vendimesh ka vendosur masa tarifore dhe jo tarifore ndaj Serbisë, si kundërpërgjigje ndaj fushatës së saj agresive për të penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare siç ishte rasti i anëtarësimit të Kosovës në Interpol si dhe fushatës diplomatike për tërheqjen e njohjeve të shtetit të Kosovës[6]. Ndonëse masat e vendosura ishin të karakterit ekonomik, Qeveria e Kosovës i vendosi ato si masa politike, madje duke i konsideruar si mjete të politikës së jashtme në relacion me Serbinë.

Në përgjigje të fushatës së ndërmarrë nga pala serbe kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol, Qeveria e Kosovës më 6 nëntor 2018, morri vendimin për vendosjen e masës mbrojtëse prej 10% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina duke përjashtuar brendet ndërkombëtare të cilat prodhohen në këto vende[7]. Pavarësisht kësaj mase të shtetit të Kosovës, diplomacia serbe vazhdoi me fushatat e saj kundër anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe tentativat për tërheqjen e njohjeve të shtetit të Kosovës.

Ndonëse krerët institucional të Kosovës kishin deklaruar se Kosova do të arrinte të anëtarësohej në Interpol pavarësisht fushatës së Serbisë[8], më 20 nëntor 2018 në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Interpol, Kosova dështoi të anëtarësohej në këtë mekanizëm multilateral[9]. Ky dështim solli reagimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila me vendim nr.01/76 të datës 21 nëntor 2018 vendosi masën prej 100% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, duke përjashtuar në këtë vendim produktet e brendeve ndërkombëtare që prodhohen në këto dy vende.

Ky vendim shkoi më tej, duke vendosur edhe masave jo tarifore ndaj produkteve të këtyre dy vendeve, me anë të aplikimit të parimit të reciprocitetit, ku u ndalua importi i produkteve të cilat në emërtim të tyre – në etiketë apo deklaracion – kanë terminologji të cilat nuk respektojnë shtetësinë e Kosovës si p.sh. 'Kosovë dhe Metohi", "Kosovo UNMIK", "Kosovo 1244". Gjithashtu u vendos për heqjen e të gjitha produkteve nga tregu të cilat përmbajtjen emërtime të tilla. Po ashtu u mor vendim për aplikimin e masave të njëjta lidhur me dokumentet dhe certifikatat që kërkohen për tregti.

Më 4 dhjetor 2018, për të ofruar shpjegim dhe për të gjetur përkrahje për vendosjen e taksës 100% ndaj produkteve serbe, Qeveria e Kosovës iu dërgoi shteteve të Kuintit përfshirë zyrën e BE-së një dokument të quajtur Memorandum[10]. Në këtë dokument, theksi kryesor u vendos tek arsyeshmëria politike e vendosjes së taksës, duke u përmendur fushata agresive e Serbisë në arenën e jashtme, ndërhyrjet në integritetin territorial dhe kushtetues, kërcënimet për luftë nga ana e Serbisë, moszbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel mes palëve, si dhe aspekte tjera. Ndërsa, sa i përket racionalitetit ekonomik të vendosjes së masës mbrojtëse, u përmenden shkelje të nivelit ekonomik të CEFTA-së, mirëpo për të cilat më parë janë evidentuar vetëm në komitetet përkatëse të CEFTA-së, pa u ngritur si çështje të diskutimit të brendshëm, apo presionit të jashtëm nëpërmjet bashkësisë ndërkombëtare.

Këto vendime nxitën reagimet e Bashkimit Evropian si dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilët rezultuan me presion eksplicit ndaj institucioneve të Kosovës për heq-

6 Për më shumë, shih: https://www.zeriamerikes.com/a/kosova-perballe-fushates-serbe-kunder-pavaresise/4514610.html
7 Për më shumë, shih: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/IMG_2387.jpg
8 Për më shumë, shih: https://www.botasot.info/aktuale-lajme/969372/pacolli-i-bindur-per-anetaresimin-e-kosoves-ne-interpol/
9 Për më shumë, shih: https://www.evropaelire.org/a/kosova-nuk-anetaresohet-ne-interpol/29610551.html
10 Për më shumë, shih: https://www.gazetaexpress.com/lajme/ekskluzive-haradinaj-u-dergon-leter-te-gjitha-shteteve-te-be-se-per-taksen-ndaj-serbise-602074/?fbclid=IwAR0dmrFwpyLECc7BJxagdDq4600JHF1tGSfmAV3XmhTh02aF3mGukVKSeW4

jen e taksës apo dhe pezullimin e së njëjtës. Presioni për tërheqjen e taksës u ndërlidh me faktin se Serbia kushtëzoi dialogun Kosovë-Serbi me këtë taksë, ndërsa pala kosovare deklaroi se pa njohjen e Serbisë, taksa nuk do të tërhiqet. Në muajt në vazhdim, presioni ndaj Qeverisë së Kosovës vazhdoi nga zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian, znj. Mogherini dhe Komisioneri për Zgjerim Z. Hahn në Prishtinë si dhe përmes letrave të qarta të dërguara nga SHBA-të, Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe takimeve të shumta të ambasadorit amerikanë në Kosovë z. Kossnet me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

Presionet shkonin kundrejt të dyja palëve duke i ftuar që të tërhiqeshin nga vendime apo veprime të cilat mund të dëmtojnë procesin e dialogut dhe mund të minojnë gjithçka që tashmë ishte arritur përgjatë këtyre viteve në kuadër të këtij procesi. Gjithsesi mungesa e qëndrimit të balancuar nga ana e BE-së ndaj veprimeve të palëve, ngjalli jo vetëm reagime nga ana e institucioneve të Kosovës me anë të letër këmbimeve por dhe nga shoqëria civile e Kosovës e cila i dërgoi znj. Mogherini letër për të shprehur shqetësimin e saj ndaj kësaj qasjeje dhe dëmin që po i bëhej vet kredibilitetit të procesit të dialogut[11].

Shteti i Serbisë vazhdoi fushatës e saj kundër shtetit të Kosovës, që rezultoi në një tjetër vendim të Qeverisë së Kosovës më 28 dhjetor 2018 ku masa prej 100% u vendos edhe ndaj brendeve ndërkombëtare të cilat prodhohen në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Në kuadër të këtij raporti të ndërtuar, nuk munguan as 'kërcënimet' se pala kosovare do të jetë e gatshme të përdor edhe masa të tjera kundrejt qasjes agresive të Serbisë ndaj shtetit të Kosovës.

Këtij vendimi i pasoi dhe një tjetër më 15 janar 2019[12], për përjashtimin e kësaj tarife për mallrat të cilat tashmë kanë hyrë në treg para vendimit për vendosjen e taksës. Ky vendim ishte diskutuar në dy mbledhje të Qeverisë ku në mbledhjen e parë, pavarësisht propozimit Qeveria nuk kishte në dispozicion informacione lidhur me sasinë e produkteve, llojin e tyre, koston e tyre kur propozoi këtë masë.

Presioni për tërheqjen e taksës u ndërlidh me faktin se Serbia kushtëzoi dialogun Kosovë-Serbi me këtë taksë, ndërsa pala kosovare deklaroi se pa njohjen e shtetit të Kosovës, taksa nuk do të tërhiqet.

11 Për më shumë, shih: http://kdi-kosova.org/aktivitetet/leter-e-hapur-per-federica-mogherini-nga-organizatat-e-shoqerise-civile-ne-kosove/?fbclid=IwAR0excEEVvQcJiFmsDlg_Kavf5tLPjDzwVUb37ZP_dPe7If14deWQ_6rMsk

12 Për më shumë shih: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/01/Vendimet-e-mbledhjes-84-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf

3. Efektet e përgjithshme të taksës ndaj Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës

Taksa prej 100% e vendosur ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës ka prodhuar efekte të ndryshme për Kosovën. Të parat janë shpërfaqur me refuzimin e Serbisë për të vazhduar dialogun pa heqjen e taksës dhe më pas me kërkesat e BE-së dhe SHBA-së për ta hequr këtë masë.

SHBA-të janë shprehur se taksa pengon arritjen e një marrëveshjeje mes palëve, që është interes strategjik i SHBA-ve. Për më shumë, që nga vendosja e taksës marrëdhëniet bilaterale në mes të Kosovës dhe SHBA-ve kanë filluar të dëmtohen. Kjo është reflektuar edhe në katër letrat e dërguara nga ana e SHBA-ve, duke filluar me letrën e presidentit Donald Trump[13], letrat nga ana e Ambasadës Amerikane në Prishtinë[14], si dhe letrën nga zyrtarët e lartë amerikanë drejtuar liderëve të vendit[15], në të cilin ishte shpërfaqur çarja e raporteve bilaterale mes vendeve, si dhe kërkesa eksplicite për pezullimin e tarifave. Vlen të theksohet se pala Amerikane kishte ardhur me një propozim ndaj Qeverisë së Kosovës për pezullim të taksës dhe mundësinë e rivendosjes së saj në rast se dështon marrëveshja me Serbinë [16].

Në planin praktik, kërkesa amerikan për pezullimin e takss është reflektuar edhe në masat e shumta ndëshkuese të ndërmarra nga SHBA-të, të tilla si refuzimi i vizës për zyrtarët qeveritarë për 'Lutjet e Mëngjesit'[17], anulimi i pjesëmarrjes së gjeneralit Timothy Orr në shënimin e përvjetorit të pavarësisë së Kosovës[18], anulimin e pjesëmarrjes në programe të Qendrës "George Marshall"[19], kërcënimi për tërheqjen e mbështetjes për FSK-në dhe të tjera.

Taksa është kundërshtuar edhe nga ana e BE-së, zyrtarët e së cilës kanë kërkuar që kjo taksë të hiqet, meqë ajo është duke penguar procesin e dialogut dhe rrezikon punën që është bërë deri më tani. Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini ka deklaruar se dialogu nuk do të vazhdojë pa heqjen e taksës[20], mirëpo që BE është e gatshme që të thërras takimin në nivel të presidentëve, posa të merret vendimi për heqjen e taksës. Lidhur me taksën është diskutuar edhe në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku shumica e vendeve kanë kërkuar pezullimin apo heqjen e të gjitha masave që janë duke bllokuar dialogun.

Refuzimi i kryeministrit për të hequr taksën pas kërkesave të SHBA-ve dhe BE-së ka shkaktuar edhe polarizim mes partnerëve të koalicionit, konkretisht mes kryeministrit Haradinaj dhe kreut të Kuvendit Kadri Veseli. Ky i fundit është shprehur që si shenjë mirëbesimi ndaj SHBA-ve dhe BE-së, duhet të bëhet pezullimi i përkohshëm i taksës, me kohëzgjatje prej vetëm 120 ditësh.[21] Ky reagim ka ardhur pas presionit ndërkombëtar dhe pas një letre që Kryeministri Haradinaj ju ka dërguar shteteve të Kuintit me 28 dhjetor 2018, për kushtet që duhet të plotësohen për tu pezulluar taksa.[22] Si rezultat i mospajtimeve rreth taksës, u vu në pikëpyetje disa herë edhe vazhdimi i koalicionit qeverisës dhe u shpeshtuan takimet mes partnerëve të koalicionit për të arritur një dakordim rreth kësaj çështjeje.

13 Për më shumë, shih: https://insajderi.com/letra-e-plote-e-trumpit-drejtuar-presidentit-thaci/
14 Për më shumë, shih: https://xk.usembassy.gov/sq/deklarate-nga-ambasada-e-shba-ve-ne-prishtine-3/
15 Për më shumë, shih: https://telegrafi.com/leter-e-ashper-nga-shba-te-per-lideret-e-kosoves-hiqeni-taksen/
16 Për më shumë, shih: https://indeksonline.net/amerika-kerkon-pezullimin-e-menjehershem-te-takses-ndaj-serbise-paralajmeron-pasoja/
17 Për më shumë, shih: http://top-channel.tv/2018/01/08/nuk-pajiset-me-vize-haradinaj-anulon-viziten-ne-shba/
18 Për më shumë, shih: https://www.evropaelire.org/a/29763387.html
19 Për më shumë, shih: https://zeri.info/aktuale/242111/ekskluzive-amerika-ia-anulon-kosoves-tete-programe-ne-qendren-marshall-ne-gjermani/
20 Për më shumë, shih: https://www.koha.net/arberi/142901/mogherini-taksa-te-hiqet-menjehere-qe-dialogu-te-vazhdoje-ndash-ska-kohe-per-te-humbur/
21 Zëri i Amerikës, "Veseli kërkon pezullim 120 ditësh të tarifave ndaj Serbisë", 28 janar 2019. E qasshme në: https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-veseli/4762233.html
22 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Letra e Kryeministrit Haradinaj dërguar ambasadorëve të Quint-it dhe përfaqësueses së BE-së në Kosovë", 28 janar 2019. E qasshme në: http://kryeministri-ks.net/letra-e-kryeministrit-haradinaj-derguar-ambasadoreve-te-quint-it-dhe-perfaqesueses-se-be-se-ne-kosove/

Edhe Presidenti i vendit Hashim Thaçi shprehu kundërshtimet e tij për mbajtjen e taksës dhe propozoi që e njëjta të pezullohet për të ruajtur partneritetin me SHBA-të.[23] Ndërsa nga ana tjetër katër kryetarët e komunave veriore, Mitrovicës së Veriut, Zubin-Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit ofruan dorëheqjen e tyre, dorëheqje e cila nuk është pranuar nga institucionet e Kosovës[24] si dhe Lista Serbe bojkotoi punën e Kuvendit[25].

Përveç efekteve politike kjo masë ka prodhuar edhe efektet ekonomike. Sipas Doganës së Kosovës, vendosja e taksës 10% fillimisht dhe pastaj 100%, ka pasur ndikim të theksuar në importet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo ka ndikuar edhe në të hyrat e Doganës së Kosovës nga Serbia ku ka pasur rënie të të hyrave në vlerë prej 20 mil€ në muajin nëntor, kur është vendosur kjo taksë.[26]

Kosova përbën rreth 3% të eksportit të përgjithshëm të Serbisë gjithsesi produktet të cilat eksportohen në Kosovë përbëjnë 21% të eksportit brenda CEFTA-s[27]. Në përgjithësi, kjo masë ka pasur një mbështetje të përgjithshme të qytetarëve ndaj taksës prej 100% pavarësisht se është raportuar për rritje të çmimeve në produkte të caktuara. Përjashtim kanë bërë qytetarët e komunitetit serb, kryesisht në Veri të Kosovës të cilët kanë organizuar protesta me anë të së cilave kanë kërkuar heqjen e kësaj mase. Në një sondazh elektronik të organizuar me 29 janar 2019 nga Gazeta Zëri, me pyetjen se a duhet të hiqet taksa, shumica e qytetarëve janë përgjigjur se taksa nuk duhet të hiqet[28].

Përveç efekteve politike kjo masë ka prodhuar edhe efektet ekonomike. Sipas Doganës së Kosovës, vendosja e taksës 10% fillimisht dhe pastaj 100%, ka pasur ndikim të theksuar në importet nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo ka ndikuar edhe në të hyrat e Doganës së Kosovës nga Serbia ku ka pasur rënie të të hyrave në vlerë prej 20 mil€ në muajin nëntor, kur është vendosur kjo taksë

23 Top Channel, Intervistë e Presidentit Thaçi, 17 shkurt 2019. E qasshme në: http://top-channel.tv/2019/02/17/kosove-thaci-taksa-do-te-pezullohet/
24 Koha Net, "Konfirmohen dorëheqjet e 4 kryetarëve të komunave me shumicë serbe në veri", 27 nëntor 2018. E qasshme në: https://www.koha.net/arberi/131152/kater-kryetaret-e-komunave-veriore-japin-doreheqje/
25 Për më shumë, shih: http://rtv21.tv/lista-serbe-mbyllet-ne-kuvend/?fbclid=IwAR1N3AFAqsEq3ysniOL8m45VoQj12Jr0AcOlAOcsrKjuWdhTcISI2eurdug
26 Platforma e KDI-së Vota Ime, "Deputetët informohen nga Doganat e Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut dhe masën mbrojtëse prej 100%", 4 dhjetor 2018. E qasshme në: http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/261
27 Për më shumë, shih: http://www.mapo.al/debati-i-ekonomisteve-a-ka-te-drejte-kosova-me-taksen-ndaj-serbise/
28 Shih këtë sondazh në Zëri: https://zeri.info/aktuale/237381/sondazh-a-duhet-te-hiqet-taksa/

4. OPSIONET PËR TAKSËN

Instituti Demokratik i Kosovës ka zhvilluar një analizë të efekteve potenciale pozitive dhe negative bazuar në pesë sfera të ndikimit lidhur me dy skenarë të cilët ndërlidhen me taksën prej 100% të vendosur ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnje e Hercegovinës.

Sferat e ndikimit janë përzgjedhur në bazë të zhvillimeve të përgjithshme duke u koncentruar në këto fusha: i) në procesin e dialogut Kosovë-Serbi, ii) në marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtar, iii) në efektet e mundshme në politikën e brendshme të Kosovës, iv) në ekonomi dhe v) në perceptimin qytetar.

Skenarët janë zhvilluar duke u bazuar në zhvillimet dhe projeksionet e mundshme lidhur me këto fusha të ndikimit. Këta skenarë janë të vlefshme në kontekstin aktual të zhvillimeve, efektet e të cilëve mund të influencohen nga faktori kohor.

SKENARËT:

SKENARI 1:

Taksa prej 100% nuk pezullohet

SKENARI 2:

Taksa prej 100% pezullohet

SKENARI 1

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Dialogu Kosovë-Serbi	Reflektimi i marrëdhënieve reale në mes të Kosovës dhe Serbisë, pozitës së Kosovës në këtë proces dhe mungesës së suksesit të vet procesit të normalizimit Ushtrimi i sovranitetit shtetëror të Kosovës në raport me Serbinë Kthimi i vëmendjes tek niveli i zbatimit të marrëveshjeve të dialogut Evitimi i afateve kohore artificiale për arritjen e marrëveshjes Fuqizimi i pozitës negociuese të Kosovës në raport me Serbinë, nëpërmjet përfshirjes së temave të caktuara në dialog si parakusht për vazhdimin e tij	Dialogu nuk vazhdon për shkak se Serbia kushtëzon dhe zvarritë procesin duke fajësuar Kosovën për mosgatishmëri për arritjen e marrëveshjes Fuqizimi i rolit dhe pozitës së Serbisë në procesin e dialogut dhe në raport me bashkësinë ndërkombëtare, në dëm të Kosovës

Taksa prej 100% nuk pezullohet

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Kosova dhe partnerët ndërkombëtarë	Rikthimi i vëmendjes së faktorit ndërkombëtar në dialogun Kosovë-Serbi Rritja e nivelit të përfshirjes së SHBA-ve në procesin e dialogut Përmirësimi i pozitës negociuese të Kosovës në raport me bashkësinë ndërkombëtare Qëndrimi më liberal i Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë për pezullimin e taksës	Marrja e vendimeve në mungesë të koordinimit me partnerët ndërkombëtar Paraqitja e Kosovës si partner jo-bashkëpunues me aleatët ndërkombëtarë Insistimi i vazhdueshëm i SHBA-ve për pezullim të taksës ndikon në acarimin e raporteve bilaterale mes Kosovës dhe SHBA-ve Lëkundja e mbështetjes së SHBA-ve për Kosovën, e manifestuar përmes masave dhe veprimeve të ndryshme ndëshkuese Bllokimi i proceseve që ndërlidhen me perspektivën evropiane për qytetarët e Kosovës Anashkalimi i Kosovës në aktivitete apo iniciativa rajonale dhe evropiane Humbja e momentumit për arritje potenciale të marrëveshjes me Serbinë, si rezultat i zgjedhjeve dhe ndryshimeve eventuale politike në BE Polarizimi i spektrit politik brenda Kosovës dëmton pozitën e shtetit në planin e jashtëm

SKENARI 1

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Aspekti politik në Kosovë	Ushtrimi i sovranitetit shtetëror në vendimmarrje Tërthorazi është nxitur një debat i gjerë shoqëror dhe politik në vend, lidhur me qasjen ndaj procesit të dialogut Kosovë-Serbi, marrëdhënieve bilaterale, dhe raportet me faktorët tjerë ndërkombëtarë Nxitja e debatit publik ka kontribuar në kërkimin e domosdoshëm të konsensusit politik për çështjet me interes shtetëror Krijimi i hapësirës kohore për ndërtimin e qëndrimit zyrtar të Kosovës lidhur me procesin e dialogut Kthimi i vëmendjes për nivelin e zbatimit të marrëveshjeve, edhe përtej atyre të arritura në kuadër të dialogut	Mungesë e strategjisë shtetërore për vendosjen e taksës dhe kushteve për tërheqjen e saj Politikë e jashtme defansive e Kosovës dhe tkurrje e saj vetëm në çështjet e dialogut dhe taksës Presioni ndërkombëtar dhe luhatja e marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtarë mund të provokojë zgjedhje të parakohshme Polarizimi midis institucionit të Presidentit, Qeverisë, partnerëve të koalicionit qeverisës dhe subjekteve tjera politike Përdorimi i taksës për qëllime politike dhe elektorale Krijimi i vakuumit institucional si pasojë e tërheqjes së komunitetit serb nga jeta institucionale dhe rreziku i rikthimit të strukturave paralele serbe Përqendrimi i vëmendjes politike dhe publike tek taksa, duke lënë nën hije temat e tjera të rëndësishme për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve

Taksa prej 100% nuk pezullohet

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Aspekti ekonomik në Kosovë	Rritja e konsumit të produkteve vendore – rritja e prodhimeve/forcimi i kompanive vendore Rritja e të hyrave tatimore në ATK nga produktet vendore Krijimi i parakushteve për zëvendësimin e produkteve të Serbisë – luftimi i politikave 'dumping' të Serbisë në tregun e Kosovës Promovimi i brendeve "Made in Kosova" Mënjanimi i perceptimit se Kosova është e varur nga produktet e Serbisë	Rritja e çmimeve të produkteve të caktuara në tregun e Kosovës Dëmtimi i pjesës së prodhuesve vendorë, të cilët lëndën e parë e kanë importuar nga Serbia Rritja e kontrabandës, veçanërisht në veri të vendit Importimi i mallrave serbe nga shtetet e tjera të rajonit Rritja e importit
Aspekti qytetar në Kosovë	Përkrahja e përgjithshme e qytetarëve për vendimet politike të institucioneve si reagim ndaj politikës agresive të Serbisë Rritja e dinjitetit shtetëror Rritja e interesimit qytetar për marrëdhëniet Kosovë-Serbi	Rritja e shqetësimit qytetar për humbjen e përkrahjes nga partnerët ndërkombëtarë Rënia e besimit ndaj procesit të dialogut Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga BE Rritja e euro-skepticizmit Rritja e populizmit

SKENARI 2

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Dialogu Kosovë-Serbi	Dialogu vazhdon Kosova forcon pozitën negociatore, sepse në tryezën e negociatave ka një instrument kushtëzues Rritja e potencialit për imponim të temave të diskutimit nga pala kosovare në dialog, me anë të mbështetjes ndërkombëtare Kosova heq etiketën e pengueses së dialogut duke u shndërruar në subjekt të përgjegjshëm dhe jo "levë kusuritjeje"	Dialogu vazhdon pa një qëndrim unik të spektrit politik në Kosovë Serbia nuk e ndërpret fushatën dhe politikat agresive ndaj shtetit të Kosovës Rreziku që Serbia ose faktori ndërkombëtar të parashtrojnë kushte të reja ndaj Kosovës Rreziku i arritjes së një marrëveshjeje që mund të paraqesë kompromis të pafavorshëm për Kosovën

Taksa prej 100% pezullohet

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Kosova dhe partnerët ndërkombëtarë	Kosova respekton partneritetin strategjik me aleatët ndërkombëtarë, veçmas me SHBA-të Raportet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë përmirësohen në të gjitha fushat e bashkëpunimit Shtohet presioni i bashkësisë ndërkombëtare ndaj Serbisë për ndaljen e qasjes destruktive dhe politikave agresive kundër shtetit të Kosovës SHBA-të, institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare të BE-së intensifikojnë mbështetjen për dialogun Kosovë-Serbi dhe shtojnë presionin për arritjen e një marrëveshje ligjërisht të obligueshme në mes të palëve	Partnerët ndërkombëtarë ushtrojnë presion për arritjen e një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë brenda një afati kohor artificial, duke mos i kushtuar vëmendje përmbajtjes së marrëveshjes eventuale

SKENARI 2

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Aspekti politik në Kosovë	Kosova eviton rrezikun e shkuarjes në zgjedhje të parakohshme si pasojë e taksës Mundësia për unifikim të qëndrimit të spektrit politik dhe institucioneve kosovare Mundësia e artikulimit të kërkesave të qarta të Kosovës ndaj partnerëve ndërkombëtarë rreth garancive që duhet të ofrohen në kuadër të dialogut Krijimi i stabilitetit të pjesshëm politik që ofron mundësi për vazhdimin e dialogut Rikthimi i komunitetit serb në jetën institucionale	Rënia e probabilitetit për rikthimin e taksës në të ardhmen Marrja e vendimeve nga Kosova nën presionin e faktorit ndërkombëtar Dobësimi i pozicionit negociues të Kosovës në kuadër të dialogut, nëse taksa pezullohet pa plotësimin e kërkesave të palës kosovare Përçarja e spektrit politik lidhur me qasjen që Kosova duhet të ketë ndaj Serbisë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve

Taksa prej 100% pezullohet

Sferat e ndikimit	Efektet pozitive	Efektet negative
Aspekti ekonomik në Kosovë	Mund të ketë ndikim në hyrat doganore Çmimet e produkteve në tregun e Kosovës nivelizohen Ulja e rasteve të kontrabandës, veçanërisht në veri të vendit	Konsumi i produkteve dhe niveli i importeve nga Serbia rritet sërish Mund të ketë ndikim negativ në nivelin e konsumit dhe prodhimit të produkteve vendore
Aspekti qytetar në Kosovë	Qytetarët mirëpresin ruajtjen e raporteve të mira me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me SHBA-të Rritja e pritshmërisë së qytetarëve ndaj BE-së lidhur me proceset integruese	Rënia e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës Rritja e ndjenjës së pafuqisë së shtetit të Kosovës përballë kushtëzimeve të Serbisë Rritja e pasigurisë lidhur me rezultatet potenciale të dialogut

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni **www.kdi-kosova.org**

Me përkrahjen financiare të:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA